



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 13.05.2023

Nr: 111

Ora: 22:00

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 60, DATË 13.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA
SUBJEKTI ZGJEDHOR “LËVIZJA BASHKË”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 13.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor “Lëvizja Bashkë”.

OBJEKT: Kundërshtimi i vendimit nr. 496, datë 11.05.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 maj deri më 10 maj 2023”.



BAZË LIGJORE: Nenet 21/b dhe 123/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” ka caktuar monitorues për fushatën zgjedhore të datës 14 Maj 2023. Për periudhën 9-10 maj 2023 janë administruar 45 (dyzet e pesë) raporte monitorimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ku janë konstatuar shkelje mbi hapjen e zyrave zgjedhore nga subjekti zgjedhor “Lëvizja Bashkë”.
2. Me vendimin nr. 496, datë 11.05.2023 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi “...urdhërimin e subjektit zgjedhor “Lëvizja Bashkë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Tiranë për mbylljen e menjëhershme të zyrës zgjedhore, si vijon: - Zyra zgjedhore afër qendrës së votimit shkolla “Avni Mula”, Bashkia Tiranë”, me arsyetimin se është hapur zyrë zgjedhore në një distancë më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve në bashkinë Tiranë, konkretisht 20 m nga shkolla “Avni Mula”.
3. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor “Lëvizja Bashkë”, i cili ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 496, datë 11.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 maj deri më 10 maj 2023”. Ankuesi pretendon se për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, partia “Lëvizja Bashkë” nuk ka hapur asnjë zyrë zgjedhore, si dhe vetmja zyrë ku ushtron aktivitetin politik është selia e partisë me adresë Rr. Abdulla Keta, Nr. 1, Tiranë.
4. Kërkesa ankimore nr. 60, datë 13.05.2023 iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Elvis Çefa. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 13.05.2023, ora 22:00. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj. Pala ankimuese e njoftuar rregullisht nuk u paraqit në seancë shqyrtimi.

5. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore nr. 60, datë 11.05.2023;
- Vendimin nr. 496, datë 11.5.2023 “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 maj deri më 10 maj 2023”;
- Raporti i monitoruesit me nr. unik 89617660, datë 10.5.2023;
- Udhëzimin nr. 06, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.
- Vendimin nr. 2, datë 02.03.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstatoi se:

1. Me vendimin nr. 496, datë 11.05.2023, Komisioneri ka urdhëruar subjektin zgjedhor “Lëvizja Bashkë”, Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake Tiranë për mbylljen e menjëhershme të zyrës zgjedhore afër qendrës së votimit shkolla “Avni Mula”, bashkia Tiranë me argumentin se kjo është zyrë elektorale e ankimuesit dhe si e tillë, referuar udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021 të KSHZ “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, nuk mund të jetë në një distancë më të afërt se 300 m nga qendra e votimit në fjalë.
2. KAS, pasi mori në shqyrtim pretendimet e ankimuesit, si edhe vendimin nr. 2, datë 02.03.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anë të të cilit partia politike “Lëvizja Bashkë” është regjistruar si parti politike me seli pikërisht në rrugën “Abdulla Keta”, Nr. 1, Tiranë, vlerëson se ky pretendimi i ankimuesit qëndron. Pra, kjo zyrë nuk është zyrë zgjedhore në kuptim të Udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, siç ka konkluduar Komisioneri,

nëpërmjet konstatimeve të raportit të monitoruesit, por në fakt është selia e partisë politike “Lëvizja Bashkë”, në të cilën ushtrohet edhe aktiviteti politik i zakonshëm i kësaj partie. Në këto kushte, kjo zyrë përjashtohet nga rregulli i parashikuar në pikën 1 të nenit 5 të udhëzimit në fjalë, sipas të cilës: *“Zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhorë mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve.”*.

3. KAS vlerëson se mbyllja krejtësisht e selisë së ankimuesit, duke ndaluar në këtë mënyrë edhe zhvillimin e aktivitetit politik të zakonshëm të kësaj partie, do të ishte një veprim joproporcional, i cili do të cënonte një të drejtë të garantuar nga Kushtetuta dhe ligji i posacëm “Për partitë politike, të anëtarëve dhe simpatizantëve të kësaj partie politike në cilësinë e saj si bashkim vullnetar i shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike. Në këtë kontekst, pavarësisht vendodhjes së kësaj zyre në raport me qendrat e votimit, ankimuesi nuk mund të zhvishet nga e drejta për të ushtruar aktivitetin e tij normal në selinë e tij në rrugën “Abdulla Keta”, Nr. 1, Tiranë.
4. Në këto kushte, KAS konkludon se pika 2 e dispozitivit të vendimit nr. 496, datë 11.5.2023 të Komisionerit duhet të shfuqizohet, duke u njoftuar njëkohësisht edhe Policia e Shtetit dhe ajo Bashkiake për lejimin e ushtrimit të aktivitetit të zakonshëm politik të partisë “Lëvizja Bashkë” në selinë e saj në adresën: rruga “Abdulla Keta”, nr. 1, Tiranë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në shkronjën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 60, datë 13.05.2023 të depozituar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja Bashkë”.

2. Shfuqizimin e pikës 2 të vendimit nr. 496, datë 11.05.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 maj deri më 10 maj 2023”.
3. Lejimin e ushtrimit të aktivitetit të zakonshëm politik të partisë politike “Lëvizja Bashkë” në selinë e saj në adresën: rruga “Abdulla Keta”, nr. 1, Tiranë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen partia politike “Lëvizja Bashkë”, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Tiranë.
5. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më 13.05.2023.

Elvis **ÇEFA** - **Relator**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Koli **BELE** - **Anëtar**

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**